

Vrojtim i Qumështit dhe Nënprodukteve të tij

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure

(ESMS)

INSTAT

Metadata Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
5. Periudha e referencës	5
6. Mandati institucional	5
7. Konfidencialiteti	5
8. Politika e botimit.....	6
9. Shpeshësia e shpërndarjes.....	7
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	7
11. Manaxhimi i cilësisë	7
12. Rëndësia.....	8
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	9
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	10
15. Koherenca dhe Krahueshmëria.....	10
16. Kostoja dhe ngarkesa	11
17. Rishikimi i të dhënave	11
18. Përpunimi statistikor	11
19. Komente.....	13
Aneks	13

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	INSTAT, Instituti i Statistikave
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave të Blegtorisë dhe Peshkimit
1.3. Personi i kontaktit	Rustem Ndroqi
1.4. Funkcioni i personit të kontaktit	Specialist në Sektorin e Statistikave të Blegtorisë dhe Peshkimit
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	Rndroqi@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356
1.8. Numri i faksit	+355 4 2228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	11.07.2019
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	11.07.2019
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Studimi i qumështit dhe nën produkteve të qumështit është një studim statistikor i kryer në ndërmarrjet që mbledhin dhe përpunojnë qumështin në territorin e Republikës së Shqipërisë. Qëllimi kryesor i vrojtimit vjetor të qumështit është të sigurojë informacion të plotë për sasinë e qumështit të papërpunuar të mbledhur nga subjektet që përpunojnë (të gjitha llojet e qumështit) dhe nënprodukteve të tij. Gjithashtu sigurohet informacion lidhur me përmbajtjen mesatare të yndyrës dhe proteinave në qumështin e grumbulluar.</p>

<p>3.2. Sistemi i klasifikimit</p>	<p>Përkufizimet janë në përputhje me rregulloret dhe vendimet e Eurostat:</p> <p>Vendimit të Komisionit Nr. 97/80 / EC, që përcakton dispozitat për zbatimin e Direktivës së Këshillit Nr. 96/16 / EC mbi vrojtimit statistikore të qumështit dhe produkteve të qumështit.</p> <p>Klasifikimi të tjera të përdorurura në Statistikat e Qumështit dhe Nënprodukteve janë si më poshtë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • RREGULLORE (KE) NR.1165/2008 “PËR STATISTIKAT E BLEGTORISË DHE TË MISHIT” • NACE Rev.2 - Statistical classification of economic activities
<p>3.3. Mbulimi i sektorit</p>	<p>Informacioni statistikor mbulon të dhëna mbi ndërmarrjet të cilat operojnë në fushën e grumbullimit dhe përpunimit të produkteve të qumështit në nace 10.51. Rritja e gjedhëve për qumësht në nace 01.41 dhe Rritja e dhenve dhe dhive në nace 01.45, sipas klasifikimit të aktivitetit ekonomik NVE Rev.2.</p>
<p>3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime</p>	<p>Sasitë e prodhuara të produkteve të qumështit: Të dhënat përfaqësojnë shumën e të gjitha produkteve të qumështit të prodhuara gjatë vitit referues.</p> <p>Qumësht për konsum: është qumështi që prodhohet për konsum në paketim 2L ose më pak. Përfshin qumështin e papërpunuar, qumështin e përpunuar, qumështin gjysëm të skremuar, qumështin e skremuar.</p> <p>Dhallë: është produkt i mbetur (mund të jenë acid ose acidifikuar) i përpunimit të qumështit ose kremeve në gjalp.</p> <p>Krem: një shtresë yndyre që formohet në mënyrë natyrale në sipërfaqen e qumështit. Përftohet duke e skremuar nga sipërfaqja e qumështit ose nxirret nga qumështi nëpërmjet procesit të centrifugimit. Kremi ka një përmbajtje të lartë yndyre (zakonisht mbi 10 %). Përfshin kremin e drejtpërdrejtë për konsum, që përmban më shumë ose më pak se 29 % e yndyrës së qumështit.</p> <p>Produkte të qumështit të acidifikuara: përfshinë kos, kos të pijshëm, qumësht i acidifikuar, qumësht dhe produkte të tjera të acidifikuara.</p> <p>Gjalpë dhe produkte të tjerë yndyrorë: janë produkte me një përmbajtje yndyre qumështi barabartë me 82 % të peshës së produktit, përmbajtje uji jo më shumë se 16 % dhe përmbajtje materiali jo yndyror prej 2 %.</p> <p>Djathë të freskët ose të stazhionuar, të ngurtë apo gjysëm-të ngurtë të përfuar nga koagulimi/mpiksja e qumështit të skremuar, gjysëm të skremuar, kremeve, kremeve të hirrës veçmas ose në kombinim nga veprimi i farës së djathit ose agjentëve të tjerë të përshtatshëm të koaguluar/mpiksuar dhe nga tharja e pjesshme e hirrës që përftohet nga koagulime/mpiksje të tilla.</p>

	<p>Djathë i butë: djathë në të cilin përmbajtja e lagështisë mbi bazën pa yndyrë pas rafinimit është jo më pak se 68 %.</p> <p>Djathë gjysëm i butë: djathë në të cilin përmbajtja e ujit mbi bazën pa yndyrë pas rafinimit është më shumë se 62 % dhe më pak se 68 %.</p> <p>Djathë gjysëm i fortë: djathë në të cilin përmbajtja e ujit mbi bazën pa yndyrë pas rafinimit është më shumë se 55 % dhe më pak se 62 %.</p> <p>Djathë i fortë: djathë në të cilin përmbajtja e ujit mbi bazën pa yndyrë pas rafinimit është më shumë se 47 % dhe më pak se 55 %.</p> <p>Djathë shumë i fortë: djathë në të cilin përmbajtja e ujit mbi bazën pa yndyrë pas rafinimit është më pak se 47 %.</p> <p>Djathë i freskët: produkti i përftuar nga fermentimi i qumështit nga i cili shumica e ujit është hequr. Gjithashtu përfshihet gjiza (përveç në formë pluhuri) më përmbajtje më shumë se 30 % ndaj peshës në formën e sheqerit dhe frutave të shtuara.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përfshinë djathë hirre të freskët (përftuar nga përqëndrimi i hirrës dhe duke shtuar qumësht ose yndyrë qumështi).
3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore e vrojtuar është Ndërmarrja.
3.6. Popullata statistikore	Statistikat e Qumështit dhe Nënprodukteve të tij përfshijnë të gjitha ndërmarrjet aktive në Shqipëri, të të gjitha formave ligjore, nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve (i vitit të mbyllur), të cilat grumbullojnë dhe përpunojnë qumësht sipas aktivitetit ekonomik NVE Rev.2, respektivisht në nace 01.41, 01.45 dhe 10.51.
3.7. Zona e referencës	Statistikat e Qumështit dhe Nënprodukteve të tij mbulojnë të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
3.8. Mbulimi në kohë	Të dhënat e Statistikave të Qumështit dhe Nënprodukteve të tij datojnë që nga viti 2014.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet
4. Njësia matëse	Njësia matëse e përdorur është mijë Ton, Kg, Përqindje (%).

5. Periudha e referencës	Të dhënat e Vrojtitit të Qumështit dhe Nënprodukteve të tij i referohen vitit kalendarik 01 Janar 2018 – 31 Dhjetor 2018.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>Baza ligjore për mbledhjen e statistikave bujqësore dhe blegtorale janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligjin Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare; • Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2017-2021 • RREGULLORE (KE) NR.1165/2008 “PËR STATISTIKAT E BLEGTORISË DHE TË MISHIT” <p>Klasifikimet dhe përkufizimet sipas rregulloreve përkatëse të BE-së.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Direktiva e Këshillit 96/16 / KE për vrojtimet statistikore të qumështit dhe produkteve të tij • COMMISSION REGULATION (EC) No 1242/2008 mbi Tipologjinë e Njësive Bujqësore • NACE Rev.2 - Nomenklatura e aktiviteteve ekonomike
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Statistikat e Qumështit dhe Nënprodukteve të tij transmetohen në EUROSTAT nëpërmjet platformës eDAMIS.
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	<p>Të dhënat e mbledhura konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 PËR STATISTIKAT ZYRTARE, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrotjtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p>
	<p>INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të</p>

<p>7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave</p>	<p>bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se:</p> <p>a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose</p> <p>b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave;</p> <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë aksesit tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojë shkallën e detajimit që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.</p>
<p>8. Politika e botimit</p>	
<p>8.1. Kalendar i publikimeve</p>	<p>Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.</p>
<p>8.2. Aksesit në kalendarin e publikimeve</p>	<p>Kalendarin e Publikimeve është në dispozicion në faqen e internetit të INSTAT.</p>
<p>8.3. Aksesit i përdoruesve</p>	<p>Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias, INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Website – online release; 2. Kërkesat e shkruara (me postë ose email); 3. Publikimi (publikimi vjetor i rezultateve të Statistikave të Qumështit dhe Nënproduktet e tij, Vjetari Statistikor Rajonal, Vjetari Statistikor). 4. Seksioni Kërkesa të dhënash, për përdoruesit e jashtëm.

9. Shpeshtësia e shpërndarjes	Statistikat e Qumështit dhe Nënprodukteve të tij publikohen në baza vjetore.
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	Njoftimi për media përmban informacion në lidhje me treguesit kryesorë të Qumështit dhe Nënproduktet e tij. Njoftimi për shtyp publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	Rezultatet për Statistikat e Qumështit dhe Nënproduktet e tij gjenden të botuara në botimin “ Statistikat e Qumështit dhe Nënproduktet e tij ”, “ Vjetarin Statistikor ”. Përdoruesit mund t’i gjejnë rezultatet në faqen e internetit të INSTAT.
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të dhënat për Statistikat e Qumështit dhe Nënproduktet e tij janë të publikuara në faqen zyrtare të INSTAT, seksioni Databaza
10.4. Aksesimi në të dhënat mikro	Të dhënat mikro nuk janë publike për përdoruesin si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Edhe pse të dhënat mikro nuk publikohen, ato mund të aksesohen në bazë të nenit 34 të Ligjit Nr. 17/2018.
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike për Statistikat e Qumështit dhe Nënproduktet e tij nëpërmjet një seksioni të dedikuar për Kërkesë të dhënash .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me Metodologjinë mbi Statistikat e Qumështit dhe Nënproduktet e tij.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave të Blegtorisë dhe Peshkimit dokumenton gjithë procesin dhe procedurat për qëllimet e brendshme.
11. Manaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “Për Statistikat Zyrtare, Nr. 17/2018, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në

	<p>kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.</p>
11.2. Vlerësimi i cilësisë	<p>Të dhënat e vrojtimit të Qumështit dhe Nënproduktet e tij krahasohen me të dhënat në vitet e mëparshme për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha. Në rastet e ndryshimeve përdoren të dhënat nga burime të tjera të mundshme për të konfirmuar situatën e rasteve kur hasen diferenca të mëdha të sjelljes së një viti me vitet e tjera.</p>
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përdoruesit mbi Statistikat e Qumështit dhe Nënproduktet e tij janë përdorues të brendshëm dhe të jashtëm, si më poshte:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Përdorues të jashtëm <ul style="list-style-type: none"> • Institucione të administratës publike • Universitetet • Organizatat jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare • Bizneset • Kërkues, student dhe grupe të tjerë të ngjashme. ➤ Përdorues të brendshëm <ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Llogarive Kombëtare • Drejtoria e Statistikave Ekonomike • Drejtoria e Statistikave Sociale • Drejtoria e Sektorit Real <p>Të cilët përdorin rezultatet e “Vrojtimit të Qumështit dhe Nënproduktet e tij” si input në punën e tyre.</p>
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Klikimet (Page Views) në lidhje me Statistikat e Blegtorisë për vitin 2018 janë rreth 2,979 klikime. INSTAT gjatë vitit 2018 ka realizuar Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve. Pyetjes: "Si e vlerësoni cilësinë e përgjithshme të Statistikave të Blegtorisë?" në shkallën nga 1 tek 5 (1=shumë e dobët, 2=e dobët, 3=e përshtatshme, 4=e mirë, 5=shumë e mirë), përdoruesit kanë vlerësuar cilësinë e të dhënave me një mesatare prej 3.10 (62 %). Rezultatet e Anketës së Kënaqësisë së Përdoruesve, 2018</p>
12.3. Plotshmëria	<p>Plotshmëria e të dhënave të vrojtimit të Qumështit dhe Nënprodukteve të tij për vitin 2018 gjykohet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar në INSTAT nga ato të rregulloreve të ndjekura. Bazuar në të dhënat e transmetuara</p>

	<p>plotshmëria e Tabelës B vlerësohet në 98.55 % (204 qeliza të dërguara/207 qeliza të kërkuara)</p> <p>Niveli i plotshmërisë të treguesve në nivel të agreguar dhe të detajuar është në përputhje të plotë me “Direktivën e Këshillit 96/16/KE e 19 marsit 1996 për anketat statistikore të qumështit dhe produkteve të tij”.</p>
<p>13. Saktësia dhe besueshmëria</p>	
<p>13.1. Saktësia e përgjithshme</p>	<p>Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishme në ecurinë e të dhënave. Në rastet kur hasen ndryshime të dhënave të anketës kontrollohen me burime alternative, nëse ka informacion. Kur nuk ka informacion nga burimet alternative, INSTAT korrigjon ose konfirmon të dhënat duke përdorur email ose duke telefonuar personat që i janë përgjigjur anketës.</p> <p>Masat e marra nga INSTAT çdo vit, për të rritur normat e përgjigjes, ose për të zvogëluar ndikimin e mos përgjigjeve janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të dhënat merren drejtpërdrejt nga ndërmarrja • Grumbullimi i të dhënave realizohet me metodën PAPI, nëpërmjet intervistës ballë për ballë me anketues me pyetësor në letër. • Staf i anketues është i trajnuar se si të sillen në mënyrë etike me rastet e personave të cilët refuzojnë të përgjigjen. • Për shkak të mungesës së sistemit të adresave, shpesh nga anketuesit është e vështirë gjetja e ndërmarrjes. Për këtë arsye, stafi i INSTAT nëpërmjet adresës së email-it ose numrit të telefonit kontakton personin përgjegjës për plotësimin e anketës dhe merr më tepër informacion mbi vendodhjen si edhe datën dhe orën e takimit. • Kur ndërmarrja refuzon të përgjigjet për intervistuesit, një kërkesë zyrtare i drejtohet presidentit të ndërmarrjes, e cila është e nënshkruar nga drejtori i përgjithshëm i INSTAT. • Kërkesë zyrtare dërgohet edhe për ndërmarrje të tjera që pranojnë të përgjigjen vetëm nëse ju kërkohet zyrtarisht informacioni. • Ndërmarrjet janë të ftuar të kontaktojnë zyrat qendrore të Institutit të Statistikave në rast të pyetjeve dhe gjithmonë një staf i kualifikuar është në dispozicion për t’iu përgjigjur pyetjeve të drejtuara nga ndërmarrjet.
<p>13.2. Gabim i kampionimit</p>	<p>Nuk aplikohet pasi është nuk është zgjedhje rastësore. Vrojtimi bazohet në listë egzostive ndërmarrjesh.</p>
<p>13.3. Gabim jo i kampionimit</p>	<p>Shkalla e përgjigjes është 100%. Veprimet për të ulur mos përgjigjen përfshijnë dërgimin e letrave kujtuese informuese për të anketuarit, thirrje telefonike, ndonjëherë vizita në rast të ndërmarrjeve të mesme ose të mëdha.</p> <p>Në rastin e mos-përgjigjes në nivel njësie, disa metoda vlerësimi përdoren</p>

	<p>përpara imputimit: bazuar në rekordin e vitit të kaluar, bazuar në tendencat e prodhimit të kësaj njësie nga fillimi i vitit aktual deri në fund të këtij viti, ose bazuar në trendin e viteve të kaluara të kësaj ndërmarrje. Shkalla e mos-përgjigjes në nivel njësie për 2018 është 0%.</p> <p>Në rastin e mos-përgjigjes në nivel variabli, variablat që mungojnë kërkohen nëpërmjet thirrjes telefonike. Gabimet teknike përballen me kontrolle automatike të cilat përfshihen në procesin e redaktimit të të dhënave. Shumë kontrolle kryhen automatikisht me ndërveprimin njerëzor. Ekzistojnë tabela shumë të hollësishme për t'u kontrolluar secili i intervistuar në nivelin e produktit dhe për të gjetur mospërputhje të mundshme. Ekzistojnë disa kontrolle aggregate që kryhen gjithashtu. Të dhënat kontrollohen në nivele të ndryshme të grumbullimeve së pari nga personat përgjegjës për aktivitetet e veçanta, pastaj nga mbikëqyrësit dhe drejtuesi i njësisë përgjegjëse.</p> <p>Mbi-mbulimi ndodh kur ndërmarrja e zgjedhur është në një aktivitet të caktuar objekt i anketimit dhe gjatë procesit të intervistimit ajo nuk është më objekt i anketimit ose statusi i ndërmarrjes ka ndryshuar, nuk është më aktive. Shkalla e mbi-mbulimit për Statistikat e Qumështit dhe Nënproduktet e tij 2018 është 11.84%.</p>								
<p>14. Afatet kohore dhe përpikmëria</p>									
<p>14.1. Afatet kohore</p>	<p>Rezultatet publikohen 192 ditë pas periudhës referencë (T+192 ditë). Dita e fundit e periudhës referuese për Statistikat e Qumështit dhe Nënproduktet e tij është 31 Dhjetori 2018.</p> <table border="1" data-bbox="435 1182 868 1308"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2018</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>07/11/2019</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>192</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2018	Data e publikimit	07/11/2019	Afatet kohore	192		
Periudha referuese	12/31/2018								
Data e publikimit	07/11/2019								
Afatet kohore	192								
<p>14.2. Përpikmëria</p>	<p>Të gjitha afatet kohore respektohen në datat e paracaktuara në kalendarin e botimeve. Publikimi i të dhënave si pjesë e botimeve të ndryshme të INSTAT, ka qenë i përpiktë në kohë në masën 100% të publikime të kryera gjatë viteve.</p> <table border="1" data-bbox="435 1486 885 1644"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2018</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>07/11/2019</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>07/11/2019</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>0</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2018	Data e shpallur	07/11/2019	Data e publikimit	07/11/2019	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2018								
Data e shpallur	07/11/2019								
Data e publikimit	07/11/2019								
Vonesa në kohë	0								
<p>15. Koherenca dhe Krahasueshmëria</p>									
<p>15.1. Krahasueshmëria gjeografike</p>	<p>Të dhënat mbi Statistikat e Qumështit dhe Nënproduktet e tij janë gjithëpërfshirëse, ato prodhohen në nivel vendi.</p>								

15.2. Krahaseshmëria kohore	Informacioni statistikor mbi Statistikat e Qumështit dhe Nënprodukteve të tij grumbullohet në të njëjtën mënyrë duke datuar nga viti 2014. Të dhënave ju bëhen kontrole të vazhdueshme për të garantuar krahasueshmërinë e tyre në seri kohore.
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Të dhënat e publikuara në lidhje me Vrojtim e Qumështit dhe Nënprodukteve të tij mund të gjenden në këto fusha të ndërlidhura si: Vrojtimi Vjetor në Bujqësi apo të dhënat administrative nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Pavarësisht ngjashmërisë të treguesve të prodhuar nga këto fusha, duhet theksuar se dallime metodologjike ekzistojnë mes të dhënave.
15.4. Koherenca e brendshme	Konsistenca e brendshme e të dhënave kontrollohen para se të finalizohen. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca në seri të ndryshme.
16. Kostoja dhe ngarkesa	Stafi i përfshirë në përgatitjen e statistikave të Qumështit dhe Nënprodukteve e tij pranë sektorit të Statistikave të Blegtorisë dhe Peshkimit është: 1 punonjës pranë zyrave qendrore të INSTAT, Stafi në Zyrat Rajonale, 17 punonjës në total, Intervistuesit, 25 gjithsej, 1 kontrollor dhe operator dhe 1 punonjës IT.
17. Rishikimi i të dhënave	
17.1. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referohuni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Politika e revizionimit • Politika e trajtimit të gabimeve
17.2. Praktika e rishikimit	Në rast burimet të cilat dërgojnë pranë INSTAT të dhënat mbi Statistikat e Qumështit dhe Nënproduktet e tij do të raportojnë ndryshime në tabelat e dërguara, ky informacion do të përditësohet dhe publikohet në publikimin e muajit të ardhshëm shoqëruar me një shënim sqarues për përdoruesit.
18. Përpunimi statistikor	
18.1. Burimi i të dhënave	Si burim i vetëm i mbledhjes së të dhënave është vrojtimi. Popullata në studim për Vrojtimin Vjetor të Qumështit dhe Nënproduktet e tij për 2018 përmban 414 ndërmarrje, të cilat janë anketuar tërësisht. Ndërmarrjet e pyetura janë të të gjitha formave ligjore dhe llojeve të pronësisë dhe që grumbullojnë dhe përpunojnë qumësht sipas aktivitetit ekonomik bazuar në NVE Rev.2. Nga kjo listë ekzistive ndërmarrjesh rezultuan të përgjigjur 365 ndërmarrje. Instrumenti i mbledhjes së të dhënave përfshin intervistimin e drejtpërdrejtë me pyetësorë letër.

18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat e Vrojtimit të Qumështit dhe Nënprodukteve të tij mbledhen në bazë vjetore. Proçesi i mbledhjes së të dhënave në terren kryhet përgjatë një muaji, në periudhën Shkurt - Mars, në të gjithë territorin e vendit.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	<p>Të dhënat e kërkuara për Vrojtimin Vjetor të Qumështit dhe Nënprodukteve të tij sigurohen nga të gjithë subjektet e regjistruar të cilët realizojnë grumbullimin dhe përpunimin e qumështit (lope, dele, dhi), me intervistim të personit përgjegjës që ka akses në të dhënat ekonomike të ndërmarrjes (ekonomist, financier, drejtor/ administrator/ president i kompanisë).</p> <p>Faza e rëndësishme në përgatitjen për grumbullimin e të dhënave është përgatitja e të gjitha materialeve të nevojshme dhe e programeve të hedhjes dhe të përpunimit të të dhënave, përgatitja e pyetësorëve. Duhet që të jenë përcaktuar ndërmarrjet që do intervistohen, numri i nevojshëm i anketuesve dhe duhet të jetë bërë përzgjedhja e tyre. Gjatë trajnimit të organizuar për anketuesit se si të kryejnë vrojtimin ata gjithashtu pajisen materiale të nevojshme si udhëzuesi i pyetësorit, detyrat e anketuesit, lista e aktiviteteve ekonomik, letër njoftimit për ndërmarrjet, lap topi si dhe bëhet një trajnim si plotësohet një pyetësor me anë të lap topit duke patur parasysh çështjet teknike informatike, etj. Anketuesit e përfshirë në këtë proçes duhet të jenë të komunikueshëm dhe shumë të qartë mbi objektivin dhe informacionin e kërkuar në anketë. Ata duhet të njohin dhe të qartësojnë ndërmarrjen e intervistuar mbi ligjin e konfidencialitetit, i cili mbron të dhënat e tyre të deklaruara për INSTAT dhe që këto të dhëna do të përdoren të grupuara e vetëm për qëllime statistikore.</p> <p>Në proçesin e mbledhjes së të dhënave janë të regjistruar çdo gjë e raportuar nga ndërmarrjet. Në rast të paqartësive, ndërmarrja ri-kontaktohet. Në rast të mospërgjigjes, ndërmarrjes i dërgohet një shkresë zyrtare e nënshkruar nga titullari i Institucionit. Anketuesit i kërkohet të sillen në mënyrë etike në rastet e refuzimeve nga ndërmarrjet. Në rast refuzimi nga ana e subjektit, anketuesit duhet të insistojnë në marrjen e informacionit të kërkuar ose të kërkojnë suportin e stafit kontrollor. Nëse edhe pas këtyre përpjekjeve ndërmarrja sërish refuzon, anketuesi shënon arsyen e refuzimit.</p>
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	<p>Sa i përket vlefshmërisë së të dhënave, procedurat e redaktimit të të dhënave në përgjithësi i referohen redaktimit në nivel mikro ose ndryshe në nivel ndërmarrje.</p> <p>1. Kontrolli i të dhënave të hedhura në program.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontrolli i pyetësorëve të hedhur, kontrole të tërësisë së plotësisë, saktësisë së vlerave dhe kontrollit logjik i pyetësorit. Numri i pyetësorëve të hedhur në program duhet të jetë i barabartë me numrin e shpërndarjes së pyetësorëve në qarqe. • Kontrole individuale janë bërë për rastet e refuzimit dhe pa kontakte. • Ndërmarrjet e përgjigjura kontrollohen për koherencën e të dhënave midis sesioneve të ndryshme të pyetësorit.

	2. Kontrolli i disa pyetjeve me anë të informacionit që mund të gjendet nga kontaktimi individual i ndërmarrjeve.
18.5. Përpilimi i të dhënave	<p>Gjatë përpunimit të të dhënave që grumbullohen çdo vit nga subjektet që grumbullojnë dhe përpunojnë qumësht, ne kontrollojmë konsistencën e brendshme të të dhënave (përfshirë konsistencën me burimet e tjera) dhe konsistencën me të dhënat nga periudhat e mëparshme. Në rast të mospërputhjeve më të mëdha, të dhënat kontrollohen duke kontaktuar njësitë raportuese.</p> <p>Për përpilimin e rezultateve kemi dy procedura bazë:</p> <p>1. Analiza e cilësisë së të dhënave Për të analizuar cilësinë e të dhënave janë aplikuar disa rregulla:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontrolli matematik i anketës - Kontrolli logjik i të dhënave të anketës • Krahasimi i të dhënave në seri kohore -Krahasimi i të dhënave me vitet e tjera • Analiza e shmangieve të mëdha nga mesatarja. <p>2. Trajtimi i mos-përgjigjeve Konsiderohen si mos-përgjigje të gjitha rastet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pa kontakt • Refuzim i plotë • Refuzime të pjesshme, (për tabela apo tregues të veçantë). <p>Për rastet e mospërgjigjeve duhet të bëhen korrigjime logjike, kur informacioni mund të nxirret nga variablat e tjerë dhe prioritet u jepet kontakteve të mëtejshme me ndërmarrjet për të mbledhur informacionet që mungojnë. Të dhënat editohen statistikisht me procedurat e duhura të imputimit si psh: imputimet logjike, imputimet mesatare, imputimet historike, etj.</p>
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
19. Komentë	
Aneks	